

Një dorëshkrim arabisht me kujtimet e të birit të Hafiz Islam Prishtinës për shpërnguljen e shqiptarëve në Damask në fillim të shek. XX.

Muhamed Mufaku

Abstrakt

Si pasojë e Luftës Ballkanike 1912-1913 që u karakterizuan me masakra dhe dhunë kolektive ndaj banorëve civilë në Vilajetin e Kosovës, mijëra shqiptarë u detyruan të largohen nga trojet e tyre në drejtim të Stambollit, prej nga disa vazhduan rrugën deri në Damask. Me kohë, Damasku u bë qendër tërheqëse për më shumë shqiptarë që u detyruan të shpërngulen nga Jugosllavia e vjetër midis dy luftimeve. Si në gjeneratën e parë, ashtu në gjeneratën e dytë që u rritë në Damask, u dalluan shumë ulema që u bënë të njohur jashtë Sirisë (H. Islam Prishtina, H. Nuh Nexhati, H. Sulejman Gavoçi, Naserudin Albani, Abdulkader Arnauti, Shuaib Aranuti e të tjerë), por nga ata nuk kemi vepra që përmbajnë kujtime të tyre për vendin që e lanë dhe për përjetimet e tyre gjatë rrugës ose në vitet e para në vendin e ri ku u vendosen. Mirëpo, në mesin e gjeneratës së dytë që u rrit në Damask, kemi tre dorëshkrime të vonshme në arabisht që hedhin dritë mbi vitet më të vështira për jetën e shqiptarëve që vendosen në Damask. Autorët e këtyre dorëshkrimeve janë bijtë e havizëve të gjeneratës së parë (Abdulvehap i biri i Hafiz Islam Prishtinës dhe Shefqet Gavoçit i biri i Hafizit Sulejman Gavoçit) dhe hoxha Abdurrahim Shaban (1912-2010), i cili arriti si fëmijë në Damask dhe mbeti e lidhur me vendlindjen. Pasi dy shkrimet u përkthyen dhe u botuan shqip, tani e kemi Kujtimet të birit të Hafiz Islam Prishtinës, Abdulvehap Xhelaludin (1928-2005).

Fjalët kyçe: Lufta Ballkanike, shpërngulja e shqiptarëve në Damask, Hafiz Islam Prishtina, Abdulvehap Xhelaludin.

Abstract

As a result of the Balkan War 1913-1913, which was characterized by mass and collective actions against the civilian inhabitants of Kosovo, thousands of Albanians were forced to leave their lands in the direction of Istanbul, from where some continued the roads to Damascus. Over time, the mask was made available to many Albanians who were forced out of the old Yugoslavia between the wars. As in the first generation, as well as in the second generation that grew up in Damascus, there were many *ulema* who became known outside of Syria (H. Islam Prishtina, H. Nuh Nexhati, H. Sulejman Gavoçi, Naserudin Albani, Abdulkader Arnauti, Shuaib Aranuti and others), but we don't have any textual inheritance that reflect their memories of places they left and of their experiences on the streets or of places where they settled. However, among the second generation that grew up in Damascus, we have three late manuscripts in Arabic that shed light on the most difficult years for the lives of Albanians who settled in Damascus. The authors of the manuscripts are the

sons of the hafizes of the first generation (Abdulvehap son of Hafiz Islam of Prishtina and Shefqet Gavoçi, son of Hafiz Sulejman Gavoç) and Hoxha Abdurrahim Shaban (1912-2010), who arrived and stayed as a child in Damascus. After the two manuscripts that were translated and published in Albanian, now we have the Memoirs of the son of Hafiz Islam of Pristina, Abdulvehap Xhelaludin (1928-2005).

Key words: *Balkan War, migration of albanians in Damascus, Hafiz Islam Prishtina, Abdulvehap Xhelaludin.*

Në krahasim me kujtimet tjera që u përmendën më lartë, këto kujtime kanë vlerë ngase autori i tyre është i biri i një figure të arsimit dhe të kulturës në Prishtinë gjatë viteve të fundit të sundimit osman: Hafiz Islam Prishtina që u shpërngul me familje nga Kosova më 1913. Të dhënat që i kemi tregojnë se ai u lind në Negovcë të Drenicës më 1888 dhe kaloi në Prishtinë për të ndjekur arsimin fillor dhe atë të mesëm (shkollën Rushdija), pastaj kaloi në medresën e njohur “Pirina”. Pasi që u tregua i aftë, ai punoi në këtë medrese deri në shpërthimin e Luftës Ballkanike në tetor 1912. Ai njihej jo vetëm si haviz dhe myderriz në medrese por ishte edhe poet dhe auror i një mevludi, si dhe një njeri me ndjenjë kombëtare që hetohet në shkrimet e tij.

Si pasojë e dhunës dhe vrasjeve të civilëve gjatë marshimit të ushtrisë serbe për në Prishtinë, Hafiz Islami vendosi të largohet me familje për në Stamboll në verë të vitit 1913. Ai u nis me nënën dhe shoqën Vehide Ahmedi, nipin Muharem Aqifi dhe i afërmi i shoqës Ismail Prishtina me nënën e vet. Siç mësojmë nga Kujtimet, Hafiz Islami kishte për cak Damaskun pasi që kishte famë edhe në mesin e shqiptarëve si qytet i shenjë (Sham sherif). Nga Stambolli për në Damask, Hafiz Islami u ndal një kohë në qytezin Kilis, i cili ishte një vend kalimtar për shqiptarët prej nga disa shkonin në Adana e disa për Halep e Damask. Atje Hafiz Islamit iu linden dy djem (Abdulgani dhe Ibrahim Haki) e disa vajzë por vdiqen atje, kurse më vonë vazhdoi rrugën për në Damask ku iu lind djali Abdulvehap, autori i Kujtimeve.

Në këto Kujtime kemi të dhëna të vlershme për arritjen e valeve të para të shqiptarëve gjatë viteve të fundit të Perandorisë osmane (1914-1918), dhe gjatë sundimit të Qeverisë Arabe 1918-1920 si dhe gjatë mandatit francez në Siri (1920- 1943). Në këto Kujtime kemi informate me vlerë për lëvizjen e shqiptarëve të ardhur në Damask në disa lagje të qytetit deri kur më 1935 themeluan një bërthamë të një lagjeje të tyre, e cila u rrit pasi që e ndërtuam më 1949 xhaminë e parë me emrin e tyre (Xhamia e arnautëve). Kështu, në vitet 20-30 të shek. XX, kur me rritjen e numrit të shqiptarëve të shpërngullur

nga Kosova nën presionin e regjimit të Jugosllavisë së vjetër, shumica e “muhaxhirëve” (ashtu siç janë quajtur atje) ishin prej fshatrave të Kosovës, kurse ata i kishin tre ulema të ardhur nga qytete me traditë fetare kuturore: Hafiz Islam nga Prishtina, Hafiz Nuh Nexhati e Hafiz Sulejman Gavoçi nga Shkodra dhe Hafiz Hamid Buhtjari nga Tetova. Mu për këtë, Kujtimet pasqyrojnë gjendjen dhe rolin e kësaj elite në formimin e një brez të ri ulemash që u bënë të njohur edhe jashtë Sirisë (Nasredin Albani, Abdulkadër Arnauti, Shuaib Aranauti dhe Vehbi Gavoçi).

Megjithatë, Kujtimet na tregojnë sa ishte i vështirë fillimi jetës për shqiptarët e vendosur në Damask, madje edhe për elitën e përmendur. Kështu, vet Hafiz Islami u detyrua të merret me ndërtim si punëtor krah, kurse Hafiz Nuhi mbante mësim në shtëpi për djemtë të gjeneratës së re kurse ditën punonte si orëndreqës, një zanat me të cilën u morën ulematë e rinj (Nasredin Albani dhe Abdulkadër Arnauti). Megjithatë, këta ulema të gjeneratës së parë në krye me Hafiz Islamin mbanin lidhje me venlidhjen. Kështu, Hafiz Islami e mbaroi mevludin shqip me shkronja arabe në Damask dhe e dërgoi në vendlindje që të recitohet atje¹.

Mu për këtë, këto kujtime të të birit janë burim i dorës së parë për jetën e vështritë të Hafiz Islamit në Damask, pasi që ato informata që kanë të bëjnë më të atin i mori prej nënës, Vahides (1892-1980) dhe nuk gjejmë në asnjë vend tjetër. Kështu, pasi që i ati gëzonte respekt në rrethin e vet në Prishtinë si haviz e myderriz, ai del në Kujtime me përjetime të rënda duke u detyruar të punojë si punëtor në ndërtimtari deri sa u sëmure dhe vdiq më 1929. Mirëpo, përkundër asaj, ai kishte shtëpinë të hapur për moshatarët e tij dhe për të rinjtë të cilët donin të mësonin diçka, duke mbajtur edhe detyrën e imamatit në xhaminë e vogël përballë varrezave Dahdah, e cila ende ekziston atje.

Nga ana tjetër, këto kujtime na pasqyrojmë shumë mirë solidaritetin midis shqiptarëve në Damask gjatë viteve 20-30 të shek.XX. Kështu, pasi autori mbeti herët jetim dhe pas vdekjes së të atit familja nuk kishte ndonjë burim tjetër sa që nëna u detyrua të shesë "një thes" me libra të të atit, del në skenë solidariteti midis shqiptarëve

¹ Këtu kemi problem me datën e lindjes, sepse viti lunar 1348 fillon me 8 qershor 1929, kurse vet autori thotë se kishte një 3 vjet kur i vdiq babai më 1929. Më i saktë është viti 1928 që shënohet në regjistrin e gjendjes civile, pra në letërnjoftim e tij.

që e mbajti familjen deri sa fëmijët u rriten dhe morën rrugën e vet. Ky solidaritet midis shqiptarëve del me traditën e vjetër të argatësisë gjatë ndërtimit të shtëpive në lagjen e re shqiptare. Pasi shqiptarët e ngritën bërthamën e lagjes më 1935 në tokë bujqësore në veri të Damaskut, është dashur që çdo shtëpi tjetër të ndërtohet brenda natës (të enjten) e të banohet me familje të premtën, kështu që kur vijnë të shtunën policët e bashkësisë pajtoheshin me realitetin sepse sipas rregullit të asaj kohe nuk mund të rrënohej shtëpia e ndërtuar pa leje nëse është e banuar me familje. Mu për këtë, shqiptarët e Damaskut merrshin vesh përpara për ndonjë rend, kështu të enjten kur dikush i ka gati materialin ndërtimor mblidheshin bashkë dhe punonin tërë natën deri sa të bëhët "shtëpia"(vetëm një dhomë dhe një kuzhinë me banjo) gati për familjen që e kishte rendin.

Kështu, lagjja e re u ndërtua në këtë mënyrë në fushat bujqësore mbraba Leceut Francez dhe u shtri gradualisht kah Lindja. Pjesa e parë e lagjes (përendimore) u bë në vitin 1949 me xhaminë e arnautëve, afër shtëpisë së Haviz Islamit, të cilin e mbajti së pari shehu i ri Nasredin Albani e më pas shehu i ri Abdulkadër Arnaut. Për ato shtëpi të para rreth xhamisë kemi në këto Kujtime shënime me emra të banorëve shqiptarë të atyre shtëpive. Pasi shumë këto shtëpi me xhaminë u rrënuan gjatë viteve 1969-1971 në emër të urbanizimit të asaj pjesetë Damaskut, këto Kujtime të birit të Hafiz Islamit tani na shërbejnë si burim i dorës së parë për rikonstruktim të asaj pjese të lagjes bashkë me emrat e familjave shqiptare që banonin atje. Një nip tjetër i Hafiz Islamit, piktori Zuhair Xhelaludin, na ndihmoi me vizatimet e tij për rikonstruktim të pamjes së asaj lagje.

Këto Kujtime të shkruara në gjuhën arabe rreth 1978, sipas mendimit të nipit Zuhair Xheladini, përmbajnë 29 faqe të frmatës së mesme me një shkrim të mirë, e çdo faqe përmban 20-22 rreshta. Në origjinal nuk ka titull, por fillon menjëherë me Bismella, ndaj po dalin këtu me këtë titull në kllapa []. Po ashtu, në këto kllapa [] e kemi futur ndonjë fjalë që na u duk e nevojshme për të kuptuar kontekstin. Në disa vende kemi tri pika, gjë që tregon se nuk u përkthye ndonjë fragment që na u duk se do ta ngarkonte tekstin dhe do ta largonte vëmendjen e lexuesit. Për botimin kritik të Kujtimeve është dashur të bëhen disa intervenime, sidomos në prezentimin e figurave dhe vendeve të përmendura. Me këtë rast, duhet ta falënderoj nipin Zuhair Xhelaludin që e mban me xhelozitë traditën e familjes dhe nuk ngurrojë të më afrojë një kopje të Kujtimeve dhe informatat përcjellëse, si dhe

disa vizatime të veta që kanë të bëjnë me shtëpinë e familjes dhe të lagjes shqiptare.

Abdulgani Xhelaludin
[Kujtime]

Në emër të Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Falënderimi është për Allahun, Atë e falënderojmë, dhe ndihmën e Tij e kërkojmë, kërkojmë të na falë, e lusim të na mbrojë nga të këqijat që bëjmë dhe veprimet tona të liga! Atë që e udhëzon Allahu nuk ka humbje për te, atë që e humb vetveten nuk ka udhëzues për te! Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër vec Atij dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i tij. Bekimi dhe paqja e Allahut qoftë me të, familjen e tij, shokët e tij, vëllezërit e tij pa përjashtim deri në Ditën e gjykimit. Ka kohë që më sillet nëpër kokë ideja për të shkruar diçka për jetën time që të jetë dëshmi para Allhaut sa jam vonuar, duke e lutur atë të Mëshirshëm për falje, se Ai ka shumë mëshirë dhe shumë butësi e fisnikëri që mbulojnë çdo gjë. Allah i Lavdëruar, unë pranoj se kam mëkat me këtë vonesë, andaj të lutem për falje dhe mëshirë se përndryshe do të humbisja shumë.

Them, unë i varfër për Zotin, qoftë i lartësuar, Abdulvehap i biri i Islamit, i biri i Xheladinit, i cili doli muhaxhir për hir të Zotit nga qyteti i tij, Prishtina, prej trojeve shqiptare në Jugosllavi, së bashku me nënën e gruas, nëna ime Vehide Ahmedi, qoftë mëshira e Allahut mbi prindërit e mi, pasi që u mund shteti osman dhe u suprimua kalifati islamik, kur armiqtë pushtuan atdheun e të atit, u hutuan myslimanët atje dhe pësuan shumë keqtrajtime, kështu që dikush mbeti e dikush u shpërngul. Prej këtyre [që u shpërngulen] ishin, i ati me të afërmit e tij: nipi Muharem Aqifi⁽²⁾, Ismail Jusufi me nënën, të cilët shkuan në vendin e myslimanëve, në Turqi, ku qëndruan dy vjet në qytezë afër Sirisë quhet Kilis. Aty u lindën dy vëllezërit, Abdulgani dhe Ibrahim Haki, e pastaj u nisën për në Sham [Damask] që ishte qëllimi i tyre, duke u ndalur në Homs² prej nga vazhduar rrugën për në Damask/Sham ku u vendosën. Nuk e di në cilin vit u shpërngulen. Në Damask u

² Është fjala për qytetin antik Emesa ose Hemesa, i cili shtrihet përfërsisht 160 km në veri të Damaskut, përkatësisht në mesin e rrugës kryesore për në Halep.

vendosën në lagjen al-Muhaxhirin, e cila e mori emrin sipas banorëve [muhaxhirëve] që u shpërngulën prej vilajeteve pas tërheqjes së forcave osmane. Në këtë lagje kam lindur në vitin 1348 H pas disa motrave që u lindën para vëllezërve dhe pas tyre, po të gjithë vdiqën, mëshira e Zotit qoftë mbi to. Po ashtu vdiq gjyshja, nëna e babait, mëshira e Zotit qoftë mbi të. I ati ishte i thelluar në jurisproducion islamik, i njohur në popull si Hafiz Islami, një njëri i devotshëm, i kujdeshëm për obligimet fetare, me një shpirt bujarie përkundër asaj që ra në varfëri, pasi që shpenzoi ato të holla që i solli me vete nga vendi i tij.

Ai punonte herë pas here në ndërtimin e shtëpive që të fitojë që ta mbajë familjen duke refuzuar ta shtrojë dorën për ndonjë sadakë, duke u kënaqur me atë që Zoti ia ndau, për çka e falënderonte Atë. Shtëpia e tij ishte gjithë me mysafirë nga muhaxhirët, për të cilët ishte si udhëheqës shpirtëror, ashtu edhe përndasit arabë. Atëherë vendin e sundonin francezët pas tërheqjes së ushtrive osmane prej Vilajetit të Sirisë, si quhej atëherë. Më vonë, i ati u godit me një sëmundje që nuk shërua prej saj, duke u vuajtur për një kohë, andaj vëllezërit [muhaxhirët] e këshilluan që të banojë brenda Damaskut, e kështu e la lagjen al-Muhaxhirin që gjindet në Malin Kasjun në lagjen al-Zunajbija. Kjo lagje ishte buzë fushave të Damaskut nga veriu, të cilat shtrihen deri në al-Salihija³. I ati u vendos në një shtëpi këtu duke duruar vuajtjen prej sëmundjes, kurse nëna ime e gjorë, besnike dhe e përkushtuar duronte të zinjte e ullirit duke u kujdesur për të gjatë jetës, deri kur vdiq, qoftë i pranuar si muhaxhir për hir të Zotit dhe u varros në varrezat al-Dahdah në Damask. Nuk di sa ka jetuar, mëshira e Zotit qoftë mbi të dhe ishalla ia bënë një vend në xhenet ku ishalla takohemi më të nën hijen e Fronit të Tij, sepse ai u shpërngul në Sham [Damask] dhe ne u lindëm këtu dhe u vendosëm në tokën e saj të shejntë.

Unë atëherë nuk kishta më shumë se tre vjet, ndaj nuk më kujtohet. Nëna ime, e devotshme dhe besnike, u godit me pikëllim për vdekjen e tij dhe për ne, sepse ne ishim fëmijë pa ndonjë burim për jetë. Vëllau im Abdulgani kishte 13 vjet, kurse vëllau tjetër Ibrahim Haki kishte 12 vjet. I ati kishte dërguar vëllaun e madh te një zdrukthari që të mësojë zanatin, pasi që mësoi Kur'anin dhe shkrim-leximin në një shkollë fetare (kuttab), sepse kishte shumë pak shkolla [publike] dhe babai nuk kishte mundësi të shpenzonte për shkollimin e dy vëllazërve në atë kohë. Nipi i të atit, Muharemi ishte një djalë i fortë që punonte

³ Al-Salihija është një vendbanim nga mesjeta e vonshme në shpatin e malit Kasjun, kurse fushat e saja shtrihen deri në veri të Damaskut, ku u ndërtua lagja e shqiptarëve.

në qeveri, ndaj ai na mori nën kujdes dhe na mori në shtëpinë e tij në lagjen al-Dhabija në Damask. Ajo shtëpi kishte dy dhoma, në njërin rrinte ai me të shoqen Hasiben, nëna ime nga qumështi dhe nëna e Abdulhalim Muhameremit, e na la tjetrën dhomë për ne [nënës dhe vëllezërve]. Me këtë sjellje u zbut shumë pikëllimi i nënës pasi që ndjeu se nuk është e huaj as e vetmuar. Ky kujdes besnik dhe bujar nga ai dhe nëna e Abdulhamitit dhe Huseinit nuk u ndërpre. Po ashtu edhe shokët e të atit nga muhaxhirët nuk lanë pa ndonjë ndihmë. Më kujtohet si fëmijë kur ata më shihnin, më shtronin dorën mbi kokë duke më dhënë të holla. Nuk harroj asnjëherë kur më doli një dhëmbë i shtrëmbër që është dashur të hiqet, kur një prej shokëve të të atit i quajtur Haxhi Rexhepi⁴, qoftë mëshira e Zotit mbi të, më moi te dentisti për ta ndrequr atë dhëmbë. Me të kthyer në shtëpi më bleu një palë këpucë nën sandalit prej druri që e kisha, si dhe një shtof pasi e kisha një veshje shumë të vjetëruar e një ëmbëlsirë. Ai më përcolli deri në shtëpinë e vet, prej shtëpisë së tij, qoftë mëshira e Zotit mbi të, më dergoi te nëna, i shëndoshë dhe i shpërblyer, me çka zemra e saj e pikëlluar u gëzua shumë. Zoti i shpëbleftë më së miri dhe takohemi nën hijen e Fronit e Tij, atë Ditë kur nuk ka hije tjetër.

Si përmenda më parë, vëllau i madh punonte drukthëtar, kurse vëllau i dytë Hakiu punonte në përpunimn e penjve të mendafshit, në rrugën që shtrihet nga lagja jonë al-Dhahabija deri në rrugën Bagdad, të cilën pushtuesit francezë e ndërtuar nëpër kopshte të Damaskut në veri, ku prapa kësaj rruge gjinden varrezat al- Dahdah kur u varros i ati, qoftë mëshira e Zotit mbi të. Ky zanat [përpunimi i penjve të mëndafshit] kërkonte një shteg të hapur me shtylla në distanca të caktuara, ku vendosen penjtë e mandafshit që të leshohen penjtë e ngatërruar në drugëza që përdoren në vek për të thurrur një shtof mëndafshi të shtrenjtë, prej të cilit bëhet fustani që e mbulon trupin deri te këmbët, e quajtur Saja, që vinin njërëzit më fisnik e më të pasur të Damaskut. Ky ishte zanati i vëllaut tim Hakiut, kurse mjeshtrit e tij ishin Hoxha Abdohi dhe i devotshmi Ab Shakir të cilët e kishin njohur të atin në lagjen al-Dhahabija, në të cilën ishte një xhami e vogël, imam e së cilës u bë i ati si vullnetar, për çka gëzoi dashurinë e banorëve të lagjes, pra kur ishte në lagjen al-Muhaxhirin para së të sëmuret. Në këtë lagje [Muhaxhirin] dhe në lagjet e tjera përrreth banonin shumë muhaxhirë shqiptarë. Vërtetë, mjeshtrit e vëllaut na ndihmuan duke i dhënë vëllaut një një pagë të mirë, kurse në raste të shenjta si në

⁴ Sipas mendimit të nipit z. Xheladini fjala është për Rexhep Tahiri, i cili erdhi nga vala e parë e muhaxhirëve, i ati i Mahmud Rexhepit që përmendet më poshtë.

Ramzan dhe në dy festat e bajramit ata na sollën shtofë nga pazari që gjindej prapa Xhamisë Umajjade, e ndonjëherë edhe këpucë, të holla dhe ëmbëlsira, kurse gjatë bajrameve dhe në raste tjera na dërgojnë gratë e tyre për të na thirrur në shtëpitë e tyre, ndaj Allah fali ata të gjithë.

Pas një kohe u lirua një shtëpi afër shtëpisë së kujdestarit tonë haxhi Muharemi, i cili e kishte kryer atëherë obligimin për haxh dhe kaluam në të. Ajo shtëpi kishte një dhomë të madhe, një kuzhinë dhe një oborr me një hardhi që i bënte hije shtëpisë. Rreth nesh ishin Abdulhamidi dhe haxhi Abidini, mëshira e Zotit qoftë mbi ta. Nëna ime e devotshme dhe e gjindshme, paguante qeranë prej asaj që i mbetet prej pagave të dy vëllezërve dhe të asaj ç'na ndihmojë bujarët, i shpërbleftë Zoti. Në mesin e këtyre shokve të të atit në Kilis që u përmend, haxhi Qazim me gruan Hamide, të cilët na vizitonin përherë, flinin te ne e na ndihmonin. Prej këtyre ishte i ati i Abdulkadrit dhe gruaja e tij Azize, e cila më merrte me nënën në shtëpinë e saj dhe na jepte sende, ushqim dhe të holla. Po ashtu, [na ndihmuan] Abdulrahma Abu Ajjub dhe gruaja e tij Fatime, nëna e vëllezërve dhe miqve tanë Hamdi Abu Sulejman dhe vëllau i tij Jusuf Abu Abdulkader dhe shumë të tjerë, mëshira e Zotit qoftë mbi ta dhe i shpërbleftë me xhenetin që ua ka premtuar besimtarëve tanë të devotshëm.

Mbetem në këtë gjendje deri kur disa muhaxhirë shqiptarë, të cilët u njohën me këtë emër (muhaxhirët) sipas profetit, qoftë i lavdruar prej Zoti dhe shokët e tij, qoftë i shpërblyer me xhenet, vendosën të blejnë disa troje për të mdërtuar shtëpi që të banojnë atje. Haxhi Muharemi, mëshira e Zotit qoftë mbi të, foli me nënën për këtë punë. Nëna ime e devotshme kishte kursyer do të holla, nga ndihmat e bujarëve, që mbeten pas mbulimit të harxhimeve për ne, ndaj ajo i tregoi se kishte disa të holla. Ai i propozoi të blinin një truall e të ndërtojmë një dhomë që të lirohemi prej qerasë. Ishte propozimi për hajr e bereqet. Ai bleu për ne dhe për vete pranë neve nga një troll në vendin ku i kanë blerë muhaxhirët trojet e tyre, i cili u quajt më vonë Divanji, ku ishin rreth neve Xheladini, haxhi Mustafa, Muradi, Muharemi dhe Abu Ajubi⁵. Pasi që e bleu trollin, nëna ime s'kishte më të holla për ta ndërtuar dhomën në atë troll. Mirëpo, haxhi Muharremi, qoftë mëshira e Zotit mbi të dhe i shpërbleftë me xhenet bashkë me të devotshmit dhe dëshmorët, filloi punën duke hapur themelin dhed uke

⁵ Këta janë nga gjenerata e parë e muhaxhirëve: Xheladini vdiq shpejt por gruaja e tij Xhylja, me vek mbante shtëpinë. Mustafa Jabusha, Murat Slatina, Muharem Gërmova dhe Abdulrahm Jabusha që u përmend më lartë.

ndërtuar murin me bllok që përbëhej prej zallit e cementit, pastoj solli dru të duhur për tavan. Pastaj, erdhën shpejtë disa muhaxhirë hajrit që kanë përvojë me zdrukthtari si haxhi Lutfi, i cili kishte lidhje të ngushtë me të atin dhe Mahmut Rexhepi, i cili u martua me Ajshen që mbeti jetime në Kilis dhe e mori i ati në shtëpi ku u rrit si një prej familjes, si dhe Muhamed Abu Ahmed dhe Fahri Abu Fuad djemtë i devotshmit haxhi Nuhi, prej muhaxhirëve nga Shkodra e Shqipërisë dhe babai i mësuesit tonë sheh Nasredini dhe vëllaut e shokut tonë sheh Munir Abu Abdulla, qoftë mëshira e Zotit mbi ta. Brenda një nate vere u vendos tavani. Në mëngjes u trasferuam nga shtëpia me qera në lagjen al-Dhahabija, në shtëpinë e re që e përmenda. Deri në mbrëmje nëna ime e devotshme dhe e durueshme kishte pastruar dyshtemenë e dhomës, e cila ishte prej dheu dhe shtroi disa sende të thjeshta që kishim, kurse mori disa thesë dhe i shtri si perde në atë vend për dritare ku nuk kishte dritare e po ashtu në atë vend për derë ku nuk kishte derë. Pasta ajo solli llambën me gaz (kerusin) dhe pak ushqim për të ngrënë, e më vonë shtriu dyshekë për gjumë. Mirëpo, nënës nuk i erdhi gjumi prej frike, sepse rrethi i oborit ishte i lartë vetëm nja dy kuta dhe nuk kishte derë fare, kurse rreth nesh vetëm kopshte e pak fqinjë. Kur erdhi mëngjesi dy vëllezërit shkuan në punë, kurse unë mbeta me nënën e devotshme dhe durueshme. Kështu, ajo na ndërtoi shtëpinë që u rritëm në të dhe u siguruam. Pas disa ditëve na erdhi shoku i të atit haxhi Lutfi, që punonte zdrukthëtar me dy dritare dhe një derë për dhomën e vetme që e kishim dhe e vendosi xhamin në to, me çka u kompletua dhoma, Zoti i shpërbleftë.

Pas një kohe na erdhi kujdestari i familjes haxhi Muharemi, mëshira e Zotit qoftë mbi të duke e përfshirë në banorët e xhenetit dhe i shtoftë jeta e gruas, nëna ime e dytë dhe kujdestarja për nënën e merzitur, erdhi dhe ndërtoi një shtëpi ngjitas me shtëpinë tonë. Po ashtu, ai na solli një derë për shtëpinë tonë, shtroi dyshtemenë e dhomës me cement, shtroi muret me baltë të kuqe që ishte në modë atëherë dhe na hapi një bunar me një pompë, kështu që na duk që u bëmë me një pallat të bukur, ishalla Zoti i shpërblen me një pallat në xhenet. Me këtë u ndie nimeti i Zotit për ne dhe qetësua zemra e pikëlluar e nënës. Atëherë unë i kisha shtatë vjet, e çka tregova pjesërisht është prej asaj që më rrëfente nëna e devotshme dhe e durueshme e pjesërisht prej asaj që e kam përjetuar vet. Pastaj, haxhi Muharemi e këshilloi nënën që të më dërgojë mua dhe djalin Abdulhalim, vëllau im prej qumështi, në mejtepin e hoxhë Hamdiut, prej muhaxhirëve që kishte lidhje me të

atin⁶, kur jepte mësim në Kur'an, leximshkrimin dhe matematikë. Hoxha e priti mirë nënën dhe solli mirë me mua, por nuk deshi të marrë pagë për mua përkundër asaj që ishte i varfër, qoftë mëshira e Zotit mbi të.

Mbeta një muaj në këtë mejtep. Një ditë e premte erdhi në shtëpinë tonë një prej muhaxhirëve të Bosnjës që kishte lidhje me të atin, Abu Jusif Azit që punonte në fabrikën pranë Hekurudhës së Hixhazit, në stacionin e Kademit në periferi të Damaskut. Më kujtohet se në atë ditë erdhi me djalin e tij Muhamed, që ishte në moshën time, duke hipur në kalë sepse në Damask kishte shumë pak vetura që mund të numërohen me gishtat e dorës. Kur trokiti në derë, ia hapa, më buzëqeshi dhe më kërkoi nënën për t'i thënë diçka. Doli nëna dhe u ndal mbrapa derës që ta dëgjojë atë, ai u përshëndet dhe u prezentua duke ia përcjellë të falat nga gruaja e tij, e cila ishte e bija e një shoku dhe bashkëvendasi nga Prishtina. I tha se i kishte regjistruar dy djemtë e tij Muhamedin dhe Jusufin si dhe mua në Shkollën Tregtare Shkencore, duke u zotuar që t'i mbulonte shpenzimet e shkollimit deri në fund. Ai i tregoi nënës ku gjendet shtëpia e tij, prapa Xhamisë Umajjade dhe ia kërkoi që të ma sjellë mua nesër në mëngjes që të shkojë në shkollë me djemtë e tij, kurse ajo rri atje me gruan e tij derisa të kthehem prej shkolle, e prej andej kthehemi në shtëpinë tonë derisa të mësoj mirë rrugën. Të nesërmën, ajo më veshi më të mirën që e kisha, që ishte një fustan të vjetër prej pambuku quhet kunbaz dhe një palë këpucë të vjetra e të arnuara dhe arritëm atje para se të dalin Muhamed dhe vëllau i tij. E trokitëm derën dhe na hapi nëna e Muhamedit duke u përshëndetur me nënën e duke më puthur, duke na marrë në dhomën ku hanin mëngjesin. Ata na ftuan të hanim së bashku, e kur erdhi koha për shkollë na përcollën nëna ime e mëshirshme dhe e devotshme bashkë me nënën e Muhamedit.

[Nga shtëpia e tyre] nga mbraba e Xhamisë Umajjade morëm rrugën për tregun al-Buzurija, pastaj për në tregun e Mitat pashës, e prej atje në lagjën al-Hudajrija ku gjindet shkolla. Ajo ishte plotë me nëxënsit të cillët u kthyen ta shohin nëxënsin e rij që erdhi me Muhamedin dhe Jusufin duke shkuar te drejtorja e shkollës. Muhamedi foli me drejtorin për mua, pasi që i ati kishte kryer punën me të, ai më pyeti për emrin dhe emrin e babait dhe më kërkoi që të nesërmën të

⁶ Fjala është për sheh Hamdi Buhtjari(1893-1971), i cili u shpërngul nga Tetova pas Luftës ballkanike për në Damask, ku u shkollua dhe më vonë hapi një shkollë për fëmijë e pastaj punoi si profesor në shkollën al-Sa'dija. Për fat të keq biblioteka e tij nuk u ruajt.

sjellë me vete një ekstrakt nga regjistri i gjendjes civile. Pastaj dola me Muhamedin në oborr, ku kishte në mes një shadërvan dhe ulësa për rreth mureve me plot nxënës. Ishte atje një kioskë për ushqim, bombona e tjera. Kur ra zilja u rreshtuan nxënësit çdo klasë veç e veç, pastaj një nxënës disa ajete të Kur'anit e pas tij nxënësit recituan lëvdata për profetin, qoftë i bekuar prej Zoti. Pasi përfunduan, kujdestari ose naziri siç quhet drejtoi çdo klasë në vendin e vet derisa na erdhi rendi. Filloi mësimi i parë atë ditë, mësuesi – që quhej hoxhë Bexheti- filloi të lëxojë emrat e nxënësve në ditar, e pastaj më pyeti për emrin dhe e shënoi në ditar. Ai e filloi mësimin duke na mësuar alfabetin e pastaj surën e parë (al-Fatiha) nga Kur'ani i madhërueshëm. Kur u krye mësimi dolëm në oborr për pak kohë, pastaj ra zilja dhe u rreshtuan nxënësit si e përmendem në fillim të ditës dhe kujdestari i orientoi nxënësit në klasat e tyre, e kështu katër herë deri në drekë. Atëherë, nxënësit dolën në oborr për të pastruar duart e për të shkuar në resturant që të ngënë atë që e sollen me vete në mëngjes. Unë nuk solla gjë me vete, por Muhamedi dhe vëllau më morën në restaurant dhe hamë ç'sollen me vete derisa u ngopem, e pastaj dolem në oborr. Pas pak kohe, një nxënës i rritur e thirri ezanin për namazin e drekës, nxënësit morën abdes dhe dhe hyren në mesxhit dhe kur u thirr për namaz një nxënës na u bë imam kurse mësuesit u falen me ne. Pas namazit dolëm në oborr e prej atje në klasa kur kemi pasur dy orë, e pastaj shkuam për shtëpi. Kur arritën në shtëpinë e Muhamedit atje ishte duke u pritur nëna ime e devotshme dhe e durueshme së bashku me nënën bujare e Muhamedit, e kur më pa, iu gëzua shumë zemra e pikëlluar. Unë e putha dorën e saj si dhe dorën e nënës së Muhamedit, sikurse bënë Muhamedi më vëllan. Pastaj nëna ime kërkoi leje dhe shkuam për shtëpi, kur arritëm atje pasdite.

Ditën e dytë nëna ma përcolli deri në shkollë, e kisha disa ditë tjera derisa një nxënës në lagje, i cili ishte pak më i madh se unë dhe e njihte mirë rrugën për në shkollë, e kështu shkonim dhe ktheheshim së bashku. Ai ishte Ejupi, djali i Abdulrrahmanit, një prej muxhirëve që kishte lidhje me të atin, kurse nëna e tij ishte Xheva qoftë mëshira e Zotit mbi të. Shtëpia e tyre, që e ndëttuan si ne, ishte shumë afër neve, ndaj u shtua miqësia midis nënës sime dhe nënës së Ejupit, duke kaluar unë dhe nëna kohë më shumë te ata, të cilët ishin fqinj më të mirë dhe na ndihmuar shumë në të punët, Zoti i shpërbleftë. Në shkollë mbeta gjashtë vjet deri kur e kreu shkollimin fillor në saj të bujarisë së babait të Muhamedit dhe Jusufit, i cili mbuloi shpenzimet për shkollim për të gjitha këto vite për hir të zotit, qoftë mëshira e Zotit mbi të, sepse ai

kishte meritën për shkollimin dhe pjekurinë e mendjes sime. Zoti ua shpërbleftë më shumë duke e vendosur në xhenet dhe i ruajtë djemtë dhe familjen, hoxhë Bexhetii, hoxhë Muradi dhe të tjerëve, sepse ata më edukuan dhe më pasuruan më dhuntinë më të mirë, shkollimi dhe dituria. Zoti i mëshiroftë.

E krewa shkollën më 1361 H[1941 AD], gati dy vjet pas shpërthimit të Liftës II Botërore. Francezët u thyen para armiqve të tyre gjermanë, të cilët i pushtuan vendin dhe kolonitë e tyre duke përfshirë Sirinë ku ishim ne⁷. Me recesionin që ndodhi u përhapë papunësia dhe u ndie mungesa e artikujve. Vëllau i madh Abdulgani punonte në zdrucktari me një pagë që nuk na mjaftonte për nevojat e jetës, por ai na e mbajti me besnikëri e devotshmëri duke durur varfërinë. Vëllau i dytë Hakiu na u largua dhe nuk nuk na ndihmoi fare, Zoti i faltë. Pastaj u bë belaja e madhe kur anglezët, që kishin pushtuar Palestinën dhe Jordaninë, depërtuan në Siri deri sa iu afruan Damaskut, prej nga filluan ti bombardojnë pozicionet franceze. Kjo gjendje vazhdoi disa ditë që ishin më kritike, sepse nuk kishte më siguri as ushqim dhe vëllau mbeti pa shkuar në punë, derisa anglezët pushtuan Damaskun duke i dëbuar francezët me përjashtim të atyre që kaluan në anën e tyre. Pas pak kohe, anglezët hapën disa ndërmarrje, kështu që u stabilizua gjendja dhe siguria.

Në atë kohë na shpëtoi Zoti kur një njeri që e nihte vëllaun tim kur punonte në zdrucktari e thiri për të punuar në kompaninë angleze NAIRN për transportimin e udhëtarëve. Ai hyri në punë atje me një pagë si në ëndërr. Paga e tij u rrit dhe jetesa jonë u përmirësua më shumë, Zoti i shpërbleftë për këtë. Unë kisha filluar të punojë te një mjeshtër metalgëdhendës në lagjen Bab al-Barid në Damask⁸. Ai ishte Muhamed Rexhep Tahiri, një prej muhaxhirëve që e njihte të jatën. Mbete te ai katër vjet derisa fillova të mësojë këtë profesion.

Në atë kohë, vëllau dhe baca, që u kujdes gjithnjë për mua, u bë gati për martesë. Nëna ime e devotshme dhe besnike ia gjeti një vajzë të një muhaxhiri, vajza e Hamza Fevziut, i mëshiroftë Zoti. Për këtë ndërtuam edhe një dhomë, gjë që e gëzoi nënën e pikëëuar. Por ky gëzim nuk zgjati shumë sepse ajo pasi që u martua më të vëllanë disa

⁷ Më pushtimin nazist të Franës, në qershor të vitit 1940 dhe formimit të qeverisë kolaboriste më seli në Vichy, forcat franceze në Siri u rreshtuan në anën e kësaj qeverie, andaj forcat britanike të stacionuara në Jordani e Irak ndërmorën sulmin që ta neutralizojnë Sirinë nga planet e Hitlerit për Lindjen e mesme.

⁸ Një ndër lagjet më të vjetra të Damaskut sipas Portit të Postës, e cila ishte porta perëndimore e Tempulit të Jupiterit të kohës romake, që ruhet pjesërisht deri më tani.

muaj u sëmurë keq dhe u mor në spital ku vdiq. Nëna ime u pikëllua shumë për atë. Pas një kohe, të afërmit e këshilluan nënën time që ta martojë vëllau edhe një herë, a kësaj here ia ka fejuar vajzën e haxhi Lutfiut, një prej miqve të të atit që na ka ndihmuar shumë. U bë kështu, ajo mbeti te vëllau nja dhjetë vjet dhe iu lind Abdulselami, Usama që vdiq i vogël, Abdulhadi dhe Zuhari⁹. Megjithatë, puna nuk shkoi si dëshirojshëm sespe ata u ngatërruan mes vete dhe dështuam të gjitha përjekjet për pajtim deri kur vëllau u detyrua ta lëshojë atë, për çka nëna ime u pikëllua shumë. Fëmijët që mbeten te ne ishin të vegjël, ndaj nëna ime u kujdes për ta deri sa nuk mundi më ta shërbjë të gjithëve.

Ndërkohë, unë kalova me punë të një mjeshtri tjetër dhe vazhdova atje punën tetë vjet derisa e kam zorëruar mirë profesionin, Zoti i mëshiroftë dhe isha do jem në gjendje që tia kthej të mirën. Pastaj vëllau më thirri të punoj te ai në atë kompani që e përmendëm. Atje kam punuar shtatë vjet dhe u bëmë tani me të ardhura të mira. Mirëpo, ndarja e vëllaut prej gruas na prishi rehatinë dhe u bëmë me një jetë të merzitshme dhe të pikëlluar. Unë vetë nuk desha më të martohem në saj çka ndodhi me vëllaun dhe fëmijët e tij kështu që tani e kemi pasur vetëm një gajle: si të kujdesemi për shkollimin dhe rehatinë e tyre. Nëna ime e gJORë kishte një zemër të madhe, kështu që ajo bëri çmos që t'ua kompenzojë ndarjen prej nënës së tyre. Po ashtu, edhe unë kisha dashuri të sigurtë dhe simpathi të madhe. Vetë prania e tyre na lehtësonte vetminë tonë, ndaj e lus Zotin që të mund të gëzojë zemrat e tyre të pikëlluara si pasojë ç' na ndodhi atyre dhe neve. E lus ata të më fal nëse kam bërë diçka jo të mirë ndaj tyre, nëse nuk arrita t'ua plotësoj ndonjë dëshirë, le të më falin çfarëdo ..e të mbesin së bashku vëllazër të dashur, të bashkuar, të afërtë e jo të largët njeri prej tjetrit, që bashkëpunojnë në të mirë e në keq, i madhi kujdesej për të voglin dhe i vogli respekton të madhin. E nëse largohen me shtëpi le të mbesin të lidhur me zemra e shpirtëra e le të kenë kujdes për prindërit e tyre...

Kështu, unë u rrita me dashurinë e nënës së devotshme dhe besnike si dhe nën kujdesin e vëllait dhe sakrificat e tij për ne deri sa u rrita dhe u bëra gati të mbaj vetveten, duke punuar në punëtorinë që e hapa më 1379 H/1959 AD derisa u bëra plak 50 vjeçar, duke e falendruar Allahun për atë rizkun që ma dha, i kënaqur me atë që ma

⁹ Zuheiri lind më 1955 në shtëpinë që u ndërtua si e përshkroi autori, përkatësisht axha e tij, dhe u shkollua në Damask. Në shkollën e mesme filloi të merret me pikturë dhe e ruajti me disa piktura pamjen e lagjës shqiptare që u rrënua gati gjysma e saj më 1969-1971. Shih më shumë për të: Muhamed Mufaku, Piktori që ruajti kujtesën për lagjën shqiptare në Damask, Koha ditore, Prishtinë 19.09.2021.

ndau. Unë punojsha vetëm, e më vinte mirë kur më vishin nipat të punojnë me mua e të kthehem bashkë në shtëpi që të gëzohemi më shumë me pamjen e nënës, e devotshme dhe durueshme me plotë dashuri, duke pastruar shtëpinë e duke përgatitur ushqimin e duke pritur me padurim ardhjen tonë. Ajo gëzohet plotësisht kur ulemi rreth saj për ushqim, e kur na sheh të gëzuar e të qeshur afër saj. E në mëngjes kur shkojmë unë me vëllanë në punë e fëmijët në shkollë e lut Zotin për në që të ruajë e të bekojë rizkun e halalit. Kështu, e kam jetuar afër saj ditë më të mira e më të embëla të jetës sime, e nuk kisha ndonjë gajle veç të jem afër saj duke kërkuar bekemin e saj e duke përpjekur për të gëzuar zemrën e saj të madh të pikëlluar e të mëshirshëm...

Ajo e gjora, e devotshme dhe e durueshme binte sëmurë ndonjë herë, gjë që na bënte të gjithëve të mërzitemi e të bëjmë çmos të ndihet më lehtë. Ajo kur binte sëmurë bënte si besimtarët e durueshëm që falënderojnë Zotin për të keqën e të mirën, deri kur qerohet me fuqinë e Zotit në saj të besimit të fortë dhe të durimit të saj. Mirëpo, herën e fundit mbeti gati dy muaj nuk hante por pinte ujë dhe ilaç deri kur i erdhi exheli i pashtyeshëm për çdo njeri, pasdite të së martës me 20 xhemada al-ahertë vitit 1397 H[1977 AD], kur vdiq dhe i doli shpriti në qetësi te Zoti. O Zot, nëse ky është haku Yt ne e pranojmë ç' na ke ndarë, se Ty të falendrojmë në këtë jetë dhe në jetën tjetër, sepse ne jemi të Zotit dhe Atij i këthem. E varrosem unë dhe vëllau me duartë tona në varrezat al-Dahdah afër varrit të të atit, në varrin e gruasë së parë të haxhi Muharemit...

U kthyer në shtëpi vetëm dhe atje e përjetuam ç' mungesë të madhe të saj, por nuk kemi pasur ngushllim tjetër pos ti dorëzohemi urdhërit të Zotit, që Ai na plotëson të gjitha. O Zot, na mbush zemrat tona me qetësi dhe i bën atë me njerëz më të mirë, na lë dikend pas saj e na ndreq punët. Allah, mëshira Jote mbulon çdo gjë, Ti je i butë dhe i mëshirshëm.

بسم الله الرحمن الرحيم

①

إله المجد لله نحمده ، ونستعينه ، ونستغفره
ونعوذ بالله من شرور أنفسنا وسيئات
أعمالنا من يهد الله فلا مضل له ومن
يضل فلا هادي له وأشهد أن لا إله
إلا الله وأشهد أن محمداً عبده ورسوله
وصلاة الله وسلامه عليه وعلى آله
وصحبه وأجوانه أجمعين إلى

يوم الدين .

أما بعد فقد كانت تعادني فكرة بأنه
أكتب شيئاً من تاريخ حياتي منذ
زمن لقلوبه ذكرى بما بد رمي من
تقصير في حق الله عز وجل واستغفاراً

Faqja e parë e dorëshkrimit

وَلَمْ يَكُنْ عَزَاءَنَا إِلَّا التَّسْلِيمُ بِأَمْرِ اللَّهِ وَهَبْنَا اللَّهُ
وَنَعِمَ الْوَكِيلُ فَاللَّهُمَّ أَنْزِلْ الْكِتَابَ عَلَى قُلُوبِنَا
وَارْزُقْنَا أَهْلًا خَيْرَ مَنَا وَاخْلُقْنَا فَيُخَادِمُنِي
لِنَا مِنْ أَمْرِنَا رَبَّنَا وَهَبْ رَحْمَتَكَ
كُلِّ شَيْءٍ بِرَبَّنَا إِنَّكَ رَوْفٌ رَحِيمٌ ①

Faqja e dytë e dorëshkrimit